



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	16.05.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	4262/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 612/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.612/2023 të datës 04.04.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komunës së Lipjanit, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e palejuar ankesa me numër A.nr.612/2023 e datës 04.04.2023 e parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tutje vetëm ankuesi), i punësuar në Komunën e Lipjanit, më datë 04.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së datës 28.03.2023 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Lipjanit, lidhur me kërkesën e ankuesit për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të diferencës së dy koeficienteve nga gjashtë (6) në tetë (8), për periudhën nga data 13.03.2017 deri më datë 31.01.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 12.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit, ndërsa kjo e fundit më datë 08.05.2023 ka përcjell shkresat ndërlidhur më çështjen në procedurë të shqyrtimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 3284/2023 të datës 04.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për kompensim në mënyrë retroaktive e datës 16.03.2023 nga ankuesi për Udhëheqësin e Personelit; Përgjigjen në kërkesë e datës 28.03.2023 të Udhëheqësit të Personelit; Akt Emërimit me numër AE.Nr.01-112-9562 të datës 21.01.2022; Vendimin me Nr. 1-112-11585 të datës 13.03.2017; Shkresën e datës 27.11.2014 për vendosjen e koeficienteve sipas pozitës përkatës nga DASHC/MAP; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 3500/2023 e datës 12.04.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 08.05.2023; Vendimin me numër 01 Nr. 016/01-32395 të datës 22.06.2022 për miratimin e strukturës organizative të komunës; Vendimin me Nr. 15-400/0152739 të datës 28.09.2022 për aprovimin e buxhetit për vitin 2023-2025.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shpresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Lipjanit dhe se i njëjti sipas Vendimit nr.1-112-11585 të datës 13.03.2017 ushtron pozitën *Inspektor i Ndërtimit*. Ankuesi më datë 08.12.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.1114/2022 të datës 10.01.2023 ka bërë përfundimin e procedimit administrativ, me arsyetimin se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili parasheh rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publik, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave, kështu që objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, ngase edhe nëse do të kishte vendimmarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pagës nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave.

Ankuesi më datë 16.03.2023 ka parashtruar kërkesë të Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Lipjanit, për kompensimin e retroaktivë të dy koeficienteve nga gjashtë (6) në tetë (8), për periudhën nga data 13.03.2017 deri më datë 31.01.2023. Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 28.03.2023, ka njoftuar ankuesin se Zyra e Personelit nuk është kompetente për ndryshimin e koeficienteve dhe së me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë janë paraparë rregulla të tjera për përcaktimin e pagës.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 28.03.2023 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Lipjanit, ankuesi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që t'i njihet e drejta e kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të diferencës së koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), për periudhën nga data 13.03.2017 deri më datë 31.01.2023.

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficienteve, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi nga data 13.03.2017 është caktuar në pozitën e punës Inspektor i Ndërtimit, ku ka realizuar koeficient gjashtë (6) të pagës, ndërsa më datë 21.02.2022 i është lëshuar Akt Emërimit



me numër AE.Nr.01-112-9562 për pozitën Inspektor i Ndërtimit po me koeficient gjashtë (6) të pagës dhe se i njëjti përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 30.09.2022 (*data e parashtrimit të ankesës në Këshill për harmonizim të koeficientit*), rrjedhimisht ankuesi nuk e kishte kundërshtuar Vendimin nr.1-112-11585 të datës 13.03.2017 si dhe Akt Emërimit me numër AE.Nr.01-112-9562 të datës 21.02.2022 në kuptim të koeficientit të pagës, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (*ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi është caktuar në pozitën e inspektorit me datë 13.03.2017*), përkatësisht nenin 130 pika 1 të këtij ligji ku përcaktohej se: “Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.”, si dhe në kundërshtim me dispozita e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (*ligj i aplikueshëm në kohën e lëshimit dhe nënshkrimit të Akt Emërimit me numër AE.Nr.01-112-9562 të datës 21.02.2022*), përkatësisht nenin 127 paragrafi 1 të këtij ligji ku përcaktohet se: “Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”, andaj, mbi këtë bazë rrjedh së ankesa e ankuesit është palejueshme.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicini i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.612/2023

Avdyt BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;